

LIGJ
Nr.7522, datë 30.10.1991

PËR MIRATIMIN E URDHHRIT "NËNË TEREZA"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Të miratojë urdhrin "Nënë Tereza".

Neni 2

Urdhri "Nënë Tereza" u jepet shteteve, organizatave, shoqatave, firmave si dhe shtetasve vendas a të huaj për shërbime të shquara humanitare dhe bamirësie ndaj Shqipërisë.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.67, datë 5.11.1991 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ramiz Alia.